

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i pergjithshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti lidhur me padite e inicuar nga paditesit [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj,, [REDACTED] nga Ferizaj dhe [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditures [REDACTED] te cilet me autorizim i perfaqeson [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj per shperblim te pagave jubilar dhe percjelle ne pension, ne seancen e mbajtur me date 23.10.2015, ka marr kete:

AKTGJYKIM

REFUZOHET, ne teresi si e pabazuar, padia e paditesve [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj, me te cilen kane kerkuar qe te detyrohet e paditura qe t'ua paguan, ne emer te percjelljes ne pension, dy paga dhe tri pagave ne emer te shperblimit jubilar, se bashku me shpenzimet e procedures dhe kamaten perkatese.

Padia e paditesve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] ushtruar kunder te paditures [REDACTED], [REDACTED] per pagesen e dy pagave per percjelle ne pension dhe tri pagave ne emer te shperblimit jubilar, **KONSIDEROHET SI E TERHEQUR**.

SHPALLET JOKOMPETENTE, ne pikepamje lendore, Gjykata Themelore ne Ferizaj, perkritazi me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] ushtruar kunder te paditures [REDACTED] [REDACTED]. Pas plotefuqishmerise se ketij Aktgjykimi, lenda t'i dergohet ne kompetence te metejme, Gjykates themelore ne Prishtine, Departamenti per Ceshtje Adminsitrative.

Arsyetimi

Paditesit [REDACTED] i nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj, S [REDACTED] nga Ferizaj, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Ferizaj, [REDACTED] nga Ferizaj dhe [REDACTED] nga Ferizaj kane ushtruar kundër të paditures padi për pagesen e tri pagave mujore ne emer te shperblimit jubilar dhe dy pagave per percjelle ne pension.

Paditesit, [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe [REDACTED] kane prezantuar ne seancen e dates 23.10.2015. ne kete séance paditesit [REDACTED] dhe [REDACTED] kane mbetur ne teresi prane pretendimeve ne padi, ndersa paditesi [REDACTED] ka kerkuar qe padia e tij te konsiderohet si e terhequn.

Paditesit tjere kane qene te ftuar me rregull mungesen nuk e kishin arsyetuar ndersa te autorizuarit e te paditures kane kerkuar qe te konsiderohet si e terhequn padia e tyre.

Te autorizuarit e te paditures kane mbetur prane thksimeve ne eprgjigjet e dhena ne padi t e paditesve duke shtuar se pretendimet e tyre perkritazi me pagesen e dy pagave epr percjellje ne pension dhe tri paga ne emer te shperblimit jubilar per punen e tyre, nuk jane te bazuar ne asnje baze ligjore dhe se pretendimii tyre se jane te bazuar ne kontarten e pergjithshem kolektive jane te pabazuara duke qene se kjo kontrate ka qene ne fuqi vetem epr epruidhen kohore 010.01.2005 deri 31.12.2008, me cka paditesit nuk mudn te perfitojne nga e njejta per shkak se pretendimet e tyre jane pas dates 31.12.2008 gjegjesisht ata jane pensionuar pas kesaj date.

Perkitazi me padine e paditesit Fehmi Kashtanjeva theksojne se kjo gjykate nuk mund te kete competence lendore per faktin se ky padites ka pasur statusin e sherbysesit civil dhe per kete ceshtje kompetenete eshte gjykata adminsitrative ne Prishtine.

Gjykata per vertetimin e gjendjes se fakteve te ceshtjes kontestuese ka bere administrimin e provave si vijojne: Aktet per themelimin e marredhenies se punes se paditesve, aktet per pensionimin e paditesve. Librezat e punes se tyre kerkesat ushtruar tek e paditura dhe pergjigjet e pranuar nga e paditura.

Gjykata pas vleresimit te provave te ceshtjes, ne kuptim te nenit 8 te LPK-se, kur ka vleresaur ato vec e vec dhe se abshku si teresi, ne baze te bindjes se lire te krijuar nga gjendja e fakteve dhe provave te parashtruara nga palet ndergjygjese, ka gjetur se duhej vendosur si ne dispozitiv .

Perkitazi me pretendimet e paditesve [REDACTED] dhe [REDACTED] gjykata vlereson se ato jane te pabazuara ne ligj dhe se pretendimi i tyre mbi bazen e ekzistimit te te drejtave te tyre per kompensimin e dy pagave per percjellje ne pension dhe tri pagavve jubilare, bazuar ne kontarten e pergjithshem kolektive, nuk mund te jete i bazuar per faktin se kohezgjatja e vlefshmerise se kesaj kontrate kolektive ka qene e percaktuar brenda periudhes kohore 01.01.2005 deri 31.12.2008, dhe rrjedhimisht duke qene se paditesit pretendimet e tyre i bazojne mbi kete kontrate e ne anen tjeteter nga provat qe kane ofruar rezulton se ata jane pensionuar pas dates 31.12.2008, me cka vertetohet se ata nuk mund te jene perfitues mbi bazen e percaktimeve qe ka parapare ish kontrata kolektive e vitit 2005, ndaj dhe per keto arsye atyre i u eshte refuzuar si e pabaze kerkesepadia.

Paditesit tjere edhe pse kane qene te ftuar me rregull, nuk kane prezantuar ne seancen e dates 23.10.2015, me perjashtim te paditesit [REDACTED], i cili ne seance ka kerkuar qe padia e tij te konsiderohet si e terhequr, andaj gjykata per paditesit qe nuk prezantuan ne seancen per te cilen ishin ftuar me rregull dhe mungesen e tyre nuk e kishin arsyetuar, padine e ka konsideruar si te terhequn, ne kuptim te nenit 423.3 te LPK-se, duke qene se perfaqesuesit e te paditures jane deklaruar qe gjykata padite e tyre t'i konsideron sit e terhequna.


Gjykata perkitazi me padine e pditesit [REDACTED], nga shkresat e lendes, ka vertetuar se i njehti ka patur statusin e sherbysesit civil, andaj ka shpallur jokompetente lendore kete gjykate ne kuptim te nenit 392 par.1 pika (b) e LPK-se, dhe ceshtjen i aka referuar Gjyaktes Themelore ne Prishtien – Departamenti Administrativ, si gjykate me competence lendoreepr keto ceshtje, bazuar ne Ligjin per Gjykatat.

Per arsyet e dhena me siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.156/13 date 23.10.2015

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC



GJYQTARI,

Enes Mehmeti

Keshilla juridike: Kunder ketij Aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.